

GREEN COAST HOTEL SH.P.K

NJËSIA BASHKIAKE NR. 2, RRUGA "DERVISH HIMA", PALLATI AMBASADOR 3, KATI 4, APARTAMENTI 26.

TIRANË

NUIS: L81630016O

VENDIM

I

ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME

Sot, më 17.11.2021, në orën 10.30, në selinë e Shoqërisë Green Coast Hotel sh.p.k. (më tej referuar si "Shoqëria"), mbahet mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë me të pranishë:

Green Coast Sh.p.k., një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, organizuar sipas ligjeve të Shqipërisë, me seli në Njësia Bashkiake nr.2, Rruga Dervish Hima, Pallati Ambasador 3, Kati 4, Apartamenti nr. 31, Tiranë, e regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit me NUIS: L41329038D, e cila zotëron 1 kuote te Shoqërisë Green Coast Hotel Sh.p.k qe përfaqëson 100 % (njëqind për qind) te kapitalit te Shoqërisë (Oraku i Vetëm), ne kete asamble e përfaqësuar rregullisht nga Z. Latif Drenofci shtetas shqiptar, lindur me 28.04.1970, ne Tirane madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar, mbajtes i leternjoftimit me nr. 035681762, dhe me numer personal H00428169D, madhor e me zotesi te plote juridike per te vepruar, në cilësinë e Administratorit.

Z. Drenofci i cili merr përsipër të kryesojë mbledhjen, fton znj. Rozana Kodrari, e cila pranon, të kryejë funksionin e sekretarit.

Kryetari i Asamblesë pasi deklaroi vullnetin e Ortakut të Vetëm për të vendosur për çështjet në rendin e ditës, pavarësisht mungesës së njoftimit për thirrjen e asamblesë, e deklaroi Asamblesën e Përgjithshme të Shoqërisë të mbledhur rregullisht bazuar në paragrafin e dytë të nenit 83 të Ligjit n. 9901/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" dhe të aftë për të marrë vendime të vlefshme mbi rendin e ditës si në vijim:

RENDI I DITËS

I. MIRATIMI I ZMADHIMIT TË KAPITALIT TË SHOQËRISË

* * * * *

Kryetari i Asamblesë në lidhje me pikën e parë dhe të dytë në Rend të Ditës parashtron se për qëllime operacionale Ortaku i Vetëm ka vendosur te kontriboje në para në shoqëri në një vlerë prej 8,300,000 LEK (tete milion e treqind mije leke). Për sa më sipër është e nevojshme që vlera e përgjithshme e kapitalit të reflektohet dhe në Statutin e Shoqërisë.

Pas një vlerësimi të kujdesshëm të çështjes së Rendit të Ditës, Asambleja e Përgjithshme e Shoqërisë:

VENDOSI:

- A. Të miratojnë zmadhimin e kapitalit të Shoqërisë nëpërmjet kontributit në para në vlerën prej 8,300,000 LEK (tete milion e treqind mije lekë).
- B. Zmadhimi i kapitalit është i shlyer plotësisht nga Ortaku i Vetëm nëpërmjet derdhjes bankare.
- C. Si rezultat i miratimit të Zmadhimit të Kapitalit sipas pikave (A) dhe (B), kapitali i Shoqërisë, nga 13,398,662.45 Lekë (trembedhjetë milion e treqind e nentëdhjetë e tetëmijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e dy pike dyzetë e pese lekë) do të bëhet **21,698,662.45 LEK** (njetete e nje milion e gjashtëqind e nëntëdhjetë tete mije e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e dy pike dyzetë e pese leke).

Për sa më sipër, autorizohet Administratori i Shoqërisë, të kryejë të gjitha aplikimet e nevojshme me qëllim regjistrimin e këtij vendimi pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit personalisht ose nëpërmjet autorizimit të tjerëve.

Meqenëse nuk pati asnjë çështje tjetër për të diskutuar, Kryetari e deklaroi mbylljen e Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë të mbyllur në orën 10.30.

Ky procesverbal i Asamblesë së Ortakut të Vetëm të "Green Coast Hotel sh.p.k mbahet në përputhje me nenin 90 të Ligjit nr. 9901, date 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar.

ASAMBLE E PËRGJITHSHME
GREEN COAST HOTEL SH.P.K
ORTAKU I VETEM
GREEN COAST SH.P.K.
KRYETAR


LATIF DRENOFCI



SEKRETARE


ROZANA KODRARI